

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: BLERJE MATERIALE KANCELARIE E NDARË NË 3
LOTE, MARRËVESHJE KUADËR**

LOTI I "MATERIALE KANCELARIE ME BAZË LETRE"

LOTI II "MATERIALE KANCELARIE TË TJERA ZYRE"

LOTI III "BLERJE LETËR"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP) 30192000-1, 30192130-1, 30192124-6, 30197220-4, 30197620-8, 30199230-1, 30199400-4, 30233132-5

VLERA E FONDIT LIMIT I MARRËVESHJES KUADËR: “Blerje materiale kancelarie e ndarë në 3 lote” me fond limit të përgjithshëm të marrëveshjes kuadër në vlerën **10,374,396.46** (dhjetë milion e treqind e shtatëdhjetë e katër mijë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë pikë dyzet e gjashtë) **Lekë pa TVSH.**

VLERA E FONDIT LIMIT PËR LOTIN I "Materiale Kancelarie me bazë letre" me fond limit të përgjithshëm të marrëveshjes kuadër në vlerën **2,893,433.76** (dy milion e tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e tridhjetë e tre pikë shtatëdhjetë e gjashtë) **Lekë pa TVSH.**

VLERA E FONDIT LIMIT PËR LOTIN II "Materiale Kancelarie të tjera zyre" me fond limit të përgjithshëm të marrëveshjes kuadër në vlerën **1,692,292.43** (një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë e dy pikë dyzet e tre) **Lekë pa TVSH.**

VLERA E FONDIT LIMIT PËR LOTIN III "Blerje letër" me fond limit të përgjithshëm të marrëveshjes kuadër në vlerën **5,788,670.27** (pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë pikë njëzet e shtatë) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 7

LOTI I. "MATERIALE KANCELARIE ME BAZË LETRE"

FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklarimit me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të lotit të parë**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenin 42 pika 3, nenin 43 pika 2/b dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në

pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të këtij loti është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 42 pika 3 ku përcaktohet se: “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. **Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit**” dhe nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar” duke qënë se vlera e fondit limit të lotit përkatës është nën vlerën e kufirit të ulët monetar dhe kriteri për secilin lot dhe konkretisht ai i përmbushjes së xhiros hartohet në përputhje me vlerën e vetë lotit dhe jo vlerës totale të procedurës.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit për lotin e dytë është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar ” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 42 pika 3 e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 19% e vlerës së fondit limit të lotit të parë**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 42/3 dhe nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit të këtij loti. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 42 pika 3 e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke qënë se vlera e fondit limit të këtij loti është

brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë **një deklaratë** nga administratori i shoqërisë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të mallit në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendet e caktuara nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë **1 (një) mjet për transportin e mallrave** objekt prokurimi, i cili mund të jetë në pronësi/qera/huapërdorje.

Për sa më sipër operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë të dhënat për mjetin sipas formatit të mëposhtëm:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Statusi
1			Pronësi/qera/huapërdorje

- Për mjetin në pronësi duhet të paraqitet certifikata e pronësisë, ndërsa për mjetin e marrë me qera/huapërdorje duhet të paraqitet kontrata noteriale përkatëse e vlefshme.
- Për mjetin në pronësi/qera/huapërdorje duhet të paraqitet edhe leje qarkullimi, certifikata e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracioni i mjetit (i vlefshëm).

Shënim: Kriteri Nr.2.3.3 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 8. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori ekonomik kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetet që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvrimit. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të mjeteve që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës, duke marrë parasysh sasinë e mallit objekt prokurimi, numrin dhe shpërndarjen gjeografike të autoritetve kontraktore përfituese.

2.3.4 Operatori ekonomik, për të realizuar shërbimin e transportit me qëllim shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi në destinacion, duhet të ketë të punësuar minimalisht 1 (një) punonjës, si më poshtë:

Stafi	Nr.
-------	-----

Shofer /Punetor i thjeshte	1
Total	1

Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për ***muajin e fundit të deklaruar konform legjislacionit në fuqi.***
- Listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për ***muajin e fundit të deklaruar konform legjislacionit në fuqi.***
- Lejen përkatëse të drejtimit të mjetit (e vlefshme)

Shenim 2.3.4/1 :

Në lidhje me kërkesën që OE duhet të disponojë 1 (një) person me profesionin shofer/punëtor i thjeshtë, OE paraqet 1 (një) punonjës që mund të jetë regjistruar në listpagesat e shoqërisë si shofer ose punonjës i thjeshtë, por që disponon lejen përkatëse të drejtimit të mjetit dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të mallrave objekt prokurimi brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.

Per punonjesit qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Shënim 2.3.4/2: Kriteri nr.2.3.4 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 8. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori ekonomik kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri minimal prej 1 punonjësi, përkatësisht shofer/punëtor i thjeshtë, që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion, është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që janë kërkuar për kryerjen e transportit të mallrave objekt prokurimi sasisë së mallrave që do të transportohen. Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 (një) person me profesionin shofer/punëtor i thjeshtë, OE paraqet 1 (një) punonjës që mund të jetë regjistruar në listpagesat e shoqërisë si shofer ose punonjës i thjeshtë, por që disponon lejen përkatëse të drejtimit të mjetit dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të mallrave objekt prokurimi brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostrat të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike në DST, për artikujt e listuar si më poshtë:

Nr.	Emertimi i mallit	Njësia	Sasia e mostrës
24.	Bllok Fletë-Dalje 3C A5	copë	1

26.	Blok Urdhër dorëzimi	copë	1
46.	Dosje kartoni e thjeshtë e bardhë	copë	1
90.	Ndarëse letre min 40 fletë	copë	1
158.	Zarfa 23x33 cm (A4)	copë	1

- Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit në ambientet e OBP-së.
- Mostrat duhet të përputhen me cilësimet e dhëna në specifikimet përkatëse.
- Mosparaqitja e mostrave është kusht për s'kualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Autoriteti kontraktor ka gjykuar të arsyeshme paraqitjen e mostrave për disa artikuj, duke marrë në konsideratë sasinë e tyre, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit me të artikujve të paraqitur nga operatorët ekonomik. Ky kriter siguron dhe garanton autoritetin kontraktor se mallrat e ofruar janë të cilësisë së kërkuar. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Operatori ekonomik i cili oferton në më shumë se sa një Lot, duhet të ketë/disponojë kapacitetin ekonomik – financiar (pika 2.2.1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetin teknik pika 2.3.1 e seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.

Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotësohet për kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike sipas përcaktimit më sipër për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të s'kualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Data: **29.07.2024**; Ora: **11:00**; Vendi: www.app.gov.al, Operatori i Blerjeve të Përqendruara, Tiranë.

LOTI II. "MATERIALE KANCELARIE TË TJERA ZYRE"

Shtojca 7

FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të lotit të dytë**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 42 pika 3, nenin 43 pika 2/b dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të këtij loti është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 42 pika 3 ku përcaktohet se: “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. **Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit**” dhe nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar” duke qënë se vlera e fondit limit të lotit përkatës është nën vlerën e kufirit të ulët monetar dhe kriteri për secilin lot dhe konkretisht ai i përmbushjes së xhiros hartohet në përputhje me vlerën e vetë lotit dhe jo vlerës totale të procedurës.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit për lotin e dytë është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar ” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 42 pika 3 e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.3Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 19% e vlerës së fondit limit të lotit të dytë**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenin 42/3 dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit të këtij loti. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 42 pika 3 e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke qënë se vlera e fondit limit të këtij loti është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë **një deklaratë** nga administratori i shoqërisë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të mallit në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendet e caktuara nga Autoriteti Kontraktor.*

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë **1 (një) mjet për transportin** e mallrave objekt prokurimi, i cili mund të jetë në pronësi/qera/huapërdorje.

Për sa më sipër operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë të dhënat për mjetin sipas formatit të mëposhtëm:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Statusi
1			Pronesi/qera/huapërdorje

- Për mjetin në pronësi duhet të paraqitet çertifikata e pronësisë, ndërsa për mjetin e marrë me qera/huapërdorje duhet të paraqitet kontrata noteriale përkatëse e vlefshme.
- Për mjetin në pronësi/qera/huapërdorje duhet të paraqitet edhe leje qarkullimi, çertifikata e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracioni i mjetit (i vlefshëm).

Shënim: *Kriteri nr.2.3.3 do të konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit të vetedëklarimit shtojca 8. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori ekonomik kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Argumentim: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetet që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvrimit. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të mjeteve që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës, duke marrë parasysh sasinë e mallit objekt prokurimi, numrin dhe shpërndarjen gjeografike të autoriteteve kontraktore përfutuese.*

2.3.4 Operatori ekonomik, për të realizuar shërbimin e transportit me qëllim shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi në destinacion, duhet të ketë të punësuar minimalisht 1 (nje) punonjës, si më poshtë:

Stafi	Nr.
Shofer /Punetor i thjeshte	1
Total	1

Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për ***muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi.***
- Listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për ***muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi.***
- Lejen përkatëse të drejtimit të mjetit (e vlefshme)

Shenim 2.3.4/1 :

Në lidhje me kërkesën që OE duhet të disponojë 1 (një) person me profesionin shofer/punëtor i thjeshtë, OE paraqet 1 (një) punonjës që mund të jetë regjistruar në listpagesat e shoqërisë si shofer ose punonjës i thjeshtë, por që disponon lejen përkatëse të drejtimit të mjetit dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të mallrave objekt prokurimi brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.

Per punonjesit qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Shënim 2.3.4/2: Kriteri nr.2.3.4 do të konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit të vetedëklarimit shtojca 8. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori ekonomik kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri minimal prej 1 punonjësi, përkatësisht shofer/puëtor i thjeshtë, që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion, është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që janë kërkuar për kryerjen e transportit të mallrave objekt prokurimi sasisë së mallrave që do të transportohen. Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 (një) person me profesionin shofer/punëtor i thjeshtë, OE paraqet 1 (një) punonjës që mund të jetë regjistruar në listpagesat e shoqërisë si shofer ose punonjës i thjeshtë, por që disponon lejen përkatëse të drejtimit të mjetit dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të mallrave objekt prokurimi brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostrat të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike në DST, për artikujt e listuar më poshtë:

Nr.	Emërtimi i mallit	Njësia	Sasia e mostres
26.2	DVD-R, 16 x 4.7GB	copë	1
35.	Evidenciator	copë	1

47.	Kapse aktesh Nr.3	kuti	1
71.	Marker për dërrasë të zezë ose color	copë	1
123.	Stilolapsa të thjeshtë me kapak	copë	

- Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit në ambjentet e OBP-së.
- Mostrat duhet të përputhen me cilësimet e dhëna në specifikimet përkatëse.
- Mosparaqitja e mostrave është kusht për s'kualifikim.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Autoriteti kontraktor ka gjykuar të arsyeshme paraqitjen e mostrave për disa artikuj, duke marrë në konsideratë sasinë e tyre, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit me të artikujve e paraqitur nga operatorët ekonomik. Ky kriter i siguron autoritetit kontraktor se mallrat e ofruar janë të cilësisë së kërkuar. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.*

Shënim: *Operatori ekonomik i cili oferton në më shumë se sa një Lot, duhet të ketë/disponojë kapacitetin ekonomik – financiar (pika 2.2.1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetin teknik pika 2.3.1 e seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.*

Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotësohet për kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike sipas përcaktimit më sipër për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të s'kualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s'kualifikim.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Data: 29.07.2024; Ora: 11:00; Vendi: www.app.gov.al, Operatori i Blerjeve të Përqendruara, Tiranë.

LOTIN III. "BLERJE LETËR"

FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kriteret e mesipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të lotit të tretë**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 42 pika 3, nenin 43 pika 2/b dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të këtij loti është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 42 pika 3 ku përcaktohet se: “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor

duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. **Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit**” dhe nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar” duke qënë se vlera e fondit limit të lotit përkatës është nën vlerën e kufirit të ulët monetar dhe kriteri për secilin lot dhe konkretisht ai i përmbushjes së xhiros hartohet në përputhje me vlerën e vetë lotit dhe jo vlerës totale të procedurës. Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit për lotin e tretë është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar ” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 42 pika 3 e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 19% e vlerës së fondit limit të lotit të tretë**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 42/3 dhe nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit të këtij loti. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 42 pika 3 e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke qënë se vlera e fondit limit të këtij loti është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë **një deklaratë** nga administratori i shoqërisë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të mallit në adresen e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendet e caktuara nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë **1 (një) mjet për transportin e mallrave** objekt prokurimi, i cili mund të jetë në pronësi/qera/huapërdorje.

Për sa më sipër operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë të dhënat për mjetin sipas formatit të mëposhtëm:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Statusi
1			Pronesi/qera/huapërdorje

- Për mjetin në pronësi duhet të paraqitet çertifikata e pronësisë, ndërsa për mjetin e marrë me qera/huapërdorje duhet të paraqitet kontrata noteriale përkatëse e vlefshme.
- Për mjetin në pronësi/qera/huapërdorje duhet të paraqitet edhe leje qarkullimi, çertifikata e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracioni i mjetit (e vlefshme).

Shënim: Kriteri Nr.2.3.3 do të konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 8. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori ekonomik kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetet që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvrimit. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të mjeteve që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës, duke marrë parasysh sasinë e mallit objekt prokurimi, numrin dhe shpërndarjen gjeografike të autoriteteve kontraktore përfutuese.

2.3.4 Operatori ekonomik, për të realizuar shërbimin e transportit me qëllim shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi në destinacion, duhet të ketë të punësuar minimalisht 1 (nje) punonjës, si më poshtë:

Stafi	Nr.
Shofer/ Punetor i thjeshte	1
Total	1

Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për **muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi.**

- Listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për ***muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi.***
- Lejen përkatëse të drejtimit të mjetit (e vlefshme)

Shenim 2.3.4/1 :

Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 (një) person me profesionin shofer/punëtor i thjeshtë, OE paraqet 1 (një) punonjës që mund të jetë i regjistruar në listpagesat e shoqërisë si shofer ose punonjës i thjeshtë, por që disponon lejen përkatëse të drejtimit të mjetit dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të mallrave objekt prokurimi brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.

Per punonjesit qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Shënim 2.3.4/2: *Kriteri nr.2.3.4 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 8. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri minimal prej 1 punonjësi, përkatësisht shofer/punëtorë të thjeshtë, që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion, është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që janë kërkuar për kryerjen e transportit të mallrave objekt prokurimi sasisë së mallrave. Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 (një) person me profesionin shofer/punëtor i thjeshtë, OE paraqet 1 (një) punonjës që mund të jetë regjistruar në listpagesat e shoqërisë si shofer ose punonjës i thjeshtë, por që disponon lejen përkatëse të drejtimit të mjetit dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të mallrave objekt prokurimi brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.*

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostrat të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike në DST, për artikujt e listuar si më poshtë:

	Emërtimi i mallit	Njësia	Sasia e mostrës
1.	Letër fotokopje 80gr/m ²	risma 500 fletë	1
14.	Letër flip-cart	fije	1
26.	Letër adezive	fletë	1

- Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit në ambjentet e OBP-së.
- Mostrat duhet të përputhen me cilësimet e dhëna në specifikimet përkatëse për këtë lot.
- Mosparaqitja e mostrave është kusht për s’kualifikim.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Autoriteti kontraktor ka gjykuar të arsyeshme paraqitjen e mostrave për disa artikuj, duke marrë në konsideratë sasinë e tyre, me qëllim verifikimin e përpunshmërisë së specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit me të artikujve e paraqitur nga operatorët ekonomik. Ky kriter i siguron autoritetit kontraktor se mallrat e ofruar janë të cilësisë së kërkuar. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.*

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues për artikujt me nr rendor **1, 2/2, 10, 11, 14, 26, 31, 34** sipas përcaktimit të bërë në tabelën e përgjithshme për lotin e tretë duhet të paraqesë katalog / skedën teknike duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga artikujt e ofruar sipas modelit të deklaruar dhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST për lotin e tretë. Katalogu/skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të artikujve si më sipër cituar me qëllim që të gjykohet nëse malli i ofruar për artikujt me Nr rendor 1, 2/2, 10, 11, 14, 26, 31, 34 plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Katalogu /skeda teknike nëse paraqitet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet nga një përkthim i noterizuar në gjuhën shqipe.

Argumentimi: *Ky kriter është vendosur në përpunje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Kërkesa për paraqitjen e katalogëve/skedës teknike është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë AK në rastin konkret Organit Qëndror Blerës për kryerjen e verifikimeve për përpunshmërinë e specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar, paraqitur nga operatorët ekonomikë, nëse janë në përpunje me specifikimet teknike të hartuara nga Autoriteti Kontraktor përfutues për llogari të të cilit Organi Qëndror Blerës ka tagrin për të zhvilluar procedurën e prokurimit.

Shënim: *Operatori ekonomik i cili oferton në më shumë se sa një Lot, duhet të ketë/disponojë kapacitetin ekonomik – financiar (pika 2.2.1 e seksionit 2.2, të kritereve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetin teknik pika 2.3.1 e seksionit 2.3, të kritereve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.*

Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kritereve kumulative nuk plotësohet për kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike sipas përcaktimit më sipër për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të s'kualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s'kualifikim.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Data: 29.07.2024; Ora: 11:00; Vendi: www.app.gov.al, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, Tiranë.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër. Konkretisht, në rastin e ankesës/ave, procedura e shqyrtimit të ankimit në KPP për një lot, nuk ndikon tek loti tjetër. Autoriteti vijon me referencën e procedurës konkrete, pa cënuar të drejtat e operatorëve ekonomikë.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

*Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune pranë Autoriteteve Kontraktore përfituese për objektin që prokurohet, të ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si edhe në përputhje me katalogun/standartin e miratuar të specifikimeve teknike për “Blerje materiale kancelarie e ndare ne 3 lote” nga ish Agjensia e Blerjeve të Përqëndruara **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët anëtarë të njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

- Dokumentat e tenderit
- Specifikimet teknike